



**REPUBLIKA E KOSOVËS**



**KOMUNA E ISTOGUT**

### **KONTRATË PËR PUNË**

**KOMUNA E ISTOGUT** në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj. Zizë Buqupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njëren anë;

**Dhe**

Grupi I Operatorëve "Construction Group", Komuna e Istogut, të cilën e perfaqëson z.ja Arjete Aliti, me Nr. Rexh. Biznesi, 70991411 (ne vazhdim "Kontraktuesit"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

#### **TITULLI I KONTRATËS:**

#### **NDËRTIMI I KANALIZIMIT BANJË-BAICË**

<b>Nr. I prokurimit</b>	<b>633-17-3225-5-2-1/C107</b>
<b>Nr. I brendshëm</b>	<b>633 / 018 / 021 / 521</b>

#### **Neni 1 Lënda:**

**1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:**

#### **NDËRTIMI I KANALIZIMIT BANJË-BAICË**

#### **Neni 2 Çmimi**

**2.1 Çmimi total i punëve per aktivitetin e prokurimit **NDËRTIMI I KANALIZIMIT BANJË - BAICË** është: 22.841,00 € dhe me fjalë: /Njëzetëedumiijëetetëçindekatërdhjetëenjë/zerozero €**

*2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vëtmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit te kontratës.*

*2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.*

#### *Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës*

*3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:*

*Marrëveshja e kontratës;*  
*Kushtet e Veçanta të Kontratës;*  
*Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;*  
*Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshire edhe Specifikimet Teknike;*  
*Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);*  
*Plani për menaxhimin e kontratës*  
*Proçesverbalet e Vizitës në teren e mbikqyresi*

*3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.*

#### *Neni 4 Komunikimet*

*4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.*

*4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për*

pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të sigruar pranimin e komunikimit të tij.

**4.3** Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlgimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlgim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndjonë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

**4.4** Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinalë për Kontraktuesin.

*Për Autoritetin Kontraktues:*

*Për Kontraktuesin:*

<b>Emri:</b>	Zizë Bujupaj	<b>Emri:</b>	Arjete Aliti
<b>Pozita:</b>	Zyrtar Përgjigjës i Prokurimit	<b>Pozita:</b>	D re j t o r
<b>Nënshtrimi:</b>		<b>Nënshtrimi:</b>	
<b>Data:</b>	2018 	<b>Data:</b>	13.08.2018 
<b>Vula</b>		<b>Vula</b>	